



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

MINISTRIA EZHVILLIMIT EKONOMIK/ MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA/ MINISTRY OF ECONOMIC  
DEVELOPMENT

**Më datë:**

**17 Tetor 2012**

- 1) **REPUBLIKA E KOSOVËS**
- 2) **BLERËSI**

---

**MARRËVESHJE**

**Për shitblerjen e tërë kapitalit aksionar të  
Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim  
me Energji Elektrike sh.a.**

---

## Përmbajtja

1. PËRKUFIZIMET, INTERPRETIMI DHE GJUHA .....	4
2. SHITBLERJA.....	4
3. KONSIDERATAT .....	5
4. KUSHTET .....	6
5. SJELLJA PARA PËRMBYLLJES.....	6
6. PËRMBYLLJA.....	10
7. TRANSFERIMI I ASETEVE .....	12
8. GARANCITË.....	12
9. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË SË SHITËSIT .....	13
10. SHKËPUTJA .....	14
11. SIGURIA E MËTEJME .....	14
12. KONFIDENCIALITETI DHE PUBLICITETI.....	15
13. DELEGIMI .....	15
14. HEQJA DORË; VARIACIONET; PAVLEFSHMËRIA .....	15
15. KOSTOT DHE SHPENZIMET .....	16
16. PAGESAT .....	16
17. TËRËSIA E MARRËVESHJES .....	17
18. PJESËT E MARRËVESHJES .....	17
19. NJOFTIMET .....	17
20. TATIMIMI .....	19
22. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI.....	19
23. ZGJIDHJA E KONTESTEVE.....	20
24. ZBATIMI.....	22
25. MARRËDHËNIA MES PALËVE.....	22
26. AKTET SOVRANE DHE IMUNITETI.....	22
27. MIRËBESIMI.....	23
28. PAGESAT JOADEKUATE .....	23

<b>SHTOJCA 1 PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI.....</b>	<b>26</b>
<b>SHTOJCA 2 KOMPANIA.....</b>	<b>34</b>
<b>SHTOJCA 3 OBLIGIMET PËR PËRMBYLLJE TË PROCESIT .....</b>	<b>36</b>
<b>SHTOJCA 4 GARANCITË .....</b>	<b>38</b>
<b>SHTOJCA 5 KUFIZIMET E PËRGJEGJËSISË .....</b>	<b>43</b>
<b>SHTOJCA 6 MARRËVESHJA E TRANSFERIMIT .....</b>	<b>46</b>
<b>SHTOJCA 7 MARRËVESHJA E INKASIMIT .....</b>	<b>47</b>
<b>SHTOJCA 8 MARRËVESHJA PËR SHËRBIMET E PËRBASHKËTA .....</b>	<b>48</b>
<b>SHTOJCA 9 FORMULARI I LICENCËS SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË DISTRIBUCIONIT DHE LICENCËS SË SISTEMIT PUBLIK.....</b>	<b><u>49</u></b>

KJO MARRËVESHJE është lidhur më datë 17 Tetor të vitit 2012

MES

(1) **QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, me seli në ndërtesën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ish-Toskana, rr. Nëna Terezë, Prishtinë, 10000, Kosovë (në tekstin e mëtejme **Shitësi**); dhe

(2) Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A. kompanisë të themeluar në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës , me numër të regjistrimit 70888645, me adresë të regjistruar në Qytezën Pejton Mbreti Zog 1.Nr.09 Prishtinë 10000, Kosovë (“Blerësi”).

(3) **NËN KUSHTET NË VIJIM**

(A) Shitësi, përmes Komitetit të Privatizimit, ka zhvilluar një proces konkurrues të tenderimit për përzgjedhjen e investitorëve nga sektori privat që do të marrin pjesë në përgjithësi dhe do të blejnë aksionet në Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a. (në tekstin e mëtejme Kompania).

(B) Konsorciumi ka parashtruar një ofertë për të blerë tërë kapitalin e emituar të Kompanisë dhe oferta në fjalë është pranuar nga Shitësi.

(C) Për këtë arsye, Shitësi është pajtuar që t’ia shesë Blerësit aksionet, ndërsa Blerësi është pajtuar që t’i blejë Aksionet në fjalë, nën kushtet dhe konditat e kësaj Marrëveshjeje.

**ME Ç’ RAST ËSHTË ARRITUR PAJTIMI** në vijim:

## **1. Përkufizimet, interpretimi dhe gjuha**

1.1 Termet e përkufizuara në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin e dhënë në Pjesën 1 të Shtojcës 1.

1.2 Disa rregulla të caktuara për interpretimin që do të jetë i zbatueshëm për këtë Marrëveshje, janë të dhëna në Pjesën 2 të Shtojcës 1.

1.3 Gjuha e përdorur gjatë negociimit të kësaj Marrëveshjeje ka qenë gjuha angleze; kjo Marrëveshje është lidhur në gjuhën angleze dhe gjuha angleze do të jetë gjuhë mbizotëruese sa i përket të kuptuarit të qëllimit të palëve apo sa i përket konstruktimit të kësaj Marrëveshjeje.

## **2. Shitblerja**

***Obligimet për të shitur dhe për të blerë***

2.1 Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Shitësi do t'ia shesë të gjitha Aksionet (përfshirë edhe të drejtat e ndërlidhura me to deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje), ndërsa Blerësi do t'i blejë ato.

#### ***Dividendët dhe shpërndarja e tyre***

2.2 Blerësi do të fitojë të drejtën në të gjitha dividendët dhe shpërndarjet (qoftë në të hyra qoftë në kapital) të cilat deklarohen, paguhen apo realizohen nga Kompania nga data e hyrjes së kësaj Marrëveshjeje në fuqi dhe tutje.

#### ***Garancitë e nënkuptuara për pronësinë***

2.3 Shitësi garanton se:

2.3.1 ka të drejtë për të transferuar pronësinë ligjore dhe interesat mbi Aksionet, në pajtim me këtë Marrëveshje; dhe

2.3.2 se të njëjtat po i bartë pa kurrfarë pengese ligjore.

#### ***Heqja dorë nga masat paraprake***

2.4 Shitësi heq dorë (dhe garanton se do sigurojë se bartësit përkatës të aksioneve, nëse ka të tillë, do të heqin dorë) nga të gjitha të drejtat për masa paraprake apo të drejtat e ngjashme mbi Aksionet të cilat ata i bartin në bazë të statutit themeltar të Kompanisë apo në ndonjë bazë tjetër.

### **3. Konsideratat**

#### ***Konsideratat***

3.1 Aksionet do të shiten për shumën prej njëzetegjashtë milion e treqind mijë euro (€ 26,300,000) (në tekstin e mëtejme "**Çmimi i blerjes**").

#### ***Pagesa***

3.2 Çmimi i blerjes do të paguhet pas përmbylljes së procesit, në pajtim me Klauzolën 6.2 dhe me Shtojcën 3.

3.3 Kurdo që në këtë Marrëveshje është përcaktuar kryerja e ndonjë pagese nga Shitësi tek Blerësi apo nga Blerësi tek Shitësi, pagesat në fjalë do të bëhen duke kredituar Llogarinë e Paracaktuar të Blerësit apo Llogarinë e Paracaktuar të Shitësit përmes transferimit elektronik të fondeve jo më vonë se në datën e përcaktuar për kryerjen e pagesës në këtë Marrëveshje.

#### **4. Kushtet**

4.1 Përmbyllja varet dhe kushtëzohet nga plotësimi i kushteve vijuese (apo heqja dorë nga to, në pajtim me klauzolën 4.2):

4.1.1 dhënia apo bartja nga ZRRE e licencës së operatorit të sistemit të distribucionit dhe dhënia e licencës për furnizim publik për Kompaninë, të cilat i përmbahen në thelb formës së ofruar në Shtojcën 9;

4.1.2 nënshkrimi i Marrëveshjes së Transferimit, Marrëveshjes për Shërbime të Përbashkëta dhe Marrëveshjes për Inkasim, nga KEK-u dhe Kompania;

4.1.3 konfirmimi mbi formën dhe përmbajtjen pranueshme për palët, të cilat veprojnë në mënyrë të arsyeshme, nga ZRRE mbi bartjen e Kompanisë tek Blerësi;

4.1.4 miratimi nga Komiteti i Privatizimit i shitjes së Aksioneve Blerësit, në pajtim me këtë Marrëveshje;

4.1.5 realizimi i Kontratave të Ndërlidhura (përveç kushteve në ato marrëveshje që ndërlidhen me Përmbylljen); dhe

4.1.6 sigurimi i balanceve të paaudituar të gjendjes hyrëse dhe përmbyllëse të Kompanisë për Blerësin, të cilat do duhej të jenë përgatitur në pajtim me IFRS në datën e Përmbylljes, për të reflektuar transferin e asetëve sipas Marrëveshjes së Transferit.

4.2 Heqja dorë nga cilido kusht i përcaktuar në klauzolat 4.1.1 deri në 4.1.6, do të mund të bëhet vetëm pas dhënies së pëlqimit me shkrim nga Shitësi dhe Blerësi.

4.3 Palët zotohen se do të ndërmarrin të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar plotësimin e Kushteve të përcaktuara në klauzolën 4.1, sa më shpejt që të jetë e mundur pas hyrjes së kësaj marrëveshjeje në fuqi, dhe jo më vonë se në ora 17:00 (sipas kohës së Kosovës) në Datën Përfundimtare.

4.4 Në rast se Kushtet nuk janë plotësuar (apo nga to nuk është hequr dorë deri në ora 17:00 (sipas kohës së Kosovës) në Datën Përfundimtare, kjo Marrëveshje (përveç dispozitave mbijetuese, të përcaktuara në Klauzolën 10.2) do të skadojë dhe nuk do të ketë efekt, dhe asnjëra palë nuk do të mund të paraqesë kurrfarë pretendimi në bazë të saj, përveç pretendimeve që rrjedhin nga moszbatimi paraprak i kësaj Marrëveshjeje.

#### **5. Sjellja para përmbylljes**

5.1 Pa paragjykuar gjeneralitetin e Klauzolës 5.2.2, Shitësi zotohet se do të sigurojë se mes datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe datës së Përmbylljes së saj, Kompania nuk do të kryejë veprimet në vijim, përveç (i) nëse kjo kërkohet për të lidhur apo vepruar në pajtueshmëri

me kontratat e ndërlidhura; (ii) nëse është marrë pëlqim paraprak me shkrim nga Shitësi (ndërsa pëlqimet e tilla nuk do të mbahen apo vonohen pa arsye); (iii) kur kjo është e domosdoshme për të qenë në pajtueshmëri me të drejtën e zbatueshme; ose (iv) nëse kjo i është treguar Blerësit para datës së hyrjes së saj në fuqi (përfshirë, për të shmangur dyshimin, buxhetin e KEK-ut për vitin 2012):

5.1.1 nuk do të anulojë dhe nuk do të zbulojë çfarëdo borxhi material apo pretendimi, dhe nuk do të shesë apo transferojë asnjë Aset të prekshëm apo paprekshëm material që tejkalon shumën e përgjithshme;

5.1.2 nuk do të hyjë në kontrata apo nuk do t'i ndryshojë materialisht kontratat apo zotimet të cilat nuk është në gjendje t'i mbulojë pa kompensim apo të cilat përfshijnë apo mund të përfshijnë shpenzim të gjithmbarshëm vjetor prej mbi pesëqind mijë euro (€500,000);

5.1.3 nuk do të blejë dhe nuk do të shesë, dhe nuk do të pajtohet se do të blejë apo shesë, apo nuk do të krijojë apo pajtohet të krijojë ndonjë pengesë ligjore mbi pronësinë mbi Asetet materiale apo pronën, në vlerë që tejkalon shumën e përgjithshme;

5.1.4 nuk do të jep kurrfarë garancie apo dëmshpërblimi material;

5.1.5 nuk do të merr përsipër dhe nuk do të pajtohet të merr përsipër kurrfarë zotimi kapital që tejkalon shumën prej pesëqind mijë euro (€500,000); nuk do të shesë apo nuk do të pajtohet të shesë, dhe nuk do të blejë apo pajtohet të blejë kurrfarë interesi në ndonjë kompani, partneritet apo ndërmarrje tjetër;

5.1.6 nuk do të ndryshojë materialisht politikat afariste aktuale (afatshkurtra dhe afatmesme), përfshirë ato që kanë të bëjnë me nivelin e punësimit, nivelin e pagave apo beneficioneve tjera, urdhëresave, furnizimeve dhe depozitimit të mallrave;

5.1.7 nuk do të dështojë tu përmbahet procedurave aktuale operative, të riparimit apo mirëmbajtjes, në kurrfarë kuptimi material;

5.1.8 nuk do të lidhë, modifikojë apo shkëpusë (në çfarëdo kuptimi material) kontratat, licencat apo lejet që janë të rëndësishme për vazhdimin e afarizmit të Kompanisë, përveç nëse kjo është rrjedhojë e afarizmit të rëndomtë;

5.1.9 nuk do të lejojë paraqitjen e ndonjë pengu tjetër mbi Asetet e veta;

5.1.10 nuk do t'i ndryshojë politikat apo praktikat kontabilare të Kompanisë, përveç nëse kjo kërkohet nga parimet e zbatueshme të kontabilitetit;

5.1.11 nuk do të shtojë apo zvogëlojë materialisht numrin e punonjësve të angazhuar në ndonjë pjesë të biznesit, dhe nuk do të transferojë punonjësit nga njëra njësi afariste në tjetrën;

5.1.12 nuk do të kryejë kurrfarë deklarimi, shpërndarjeje, autorizimi apo pagese për aksionarët e Kompanisë, përfshirë dividendët pronësore apo në natyrë, dhe nuk do të zvogëlojë kapitalin aksionar;

5.1.13 nuk do të krijojë, ndajë, nxjerrë apo ofrojë kurrfarë opsioni mbi të drejtat tjera, në lidhje me parapagimin apo blerjen, apo rimarrjen, blerjen apo riblerjen e aksioneve të Kompanisë apo letrave me vlerë që mund të shndërrohen në aksione të tilla, apo çfarëdo huazimi të kapitalit të Kompanisë;

5.1.14 nuk do të ripaguajë, rimarrë apo riblejë kapitalin aksionar apo huazues të Kompanisë;

5.1.15 nuk do të themelojë kurrfarë firme vartëse dhe nuk do të blejë aksione në ndonjë kompani dhe nuk do të marrë pjesë apo shkëpusë pjesëmarrjen në çfarëdo partneriteti, ndërmarrje të përbashkët apo marrëveshje për ndarje të profitit;

5.1.16 nuk do të ndryshojë dokumentet kushtetuese të Kompanisë;

5.1.17 nuk do të bëjë propozime për mbylljen apo likuidimin e Kompanisë apo ndonjë skeme apo plani apo aranzhimi, rindërtimi, fuzionomi apo shpërbërjeje;

5.1.18 nuk do të hyjë në kontrata apo transaksione tjera materiale me ndonjë filial të Shitësit, përveç nëse kjo realizohet si pjesë e afarizmit të rëndomtë dhe në interes të afarizmit në fjalë;

5.1.19 nuk do të ndryshojë kushtet tjera materiale të huazimit dhe nuk do të hyjë në huazime apo borxhe të reja në emër të Kompanisë, në rast se këto shuma tejkalojnë Shumën e Gjithmbarshme, përveç nëse kjo realizohet si pjesë e afarizmit të rëndomtë;

5.1.20 nuk do të iniciojë apo lidhë marrëveshje, dhe nuk do të heqë dorë nga kontestet që janë të një rëndësie materiale për afarizmin e Kompanisë, përveç në rast se kjo ka të bëjë me inkasimin e borxheve përmes afarizmit të rëndomtë apo kontesteve gjyqësore për të cilat vlera monetare e pretendimeve është më e vogël se pesëqind mijë euro (€500,000).

5.1.21 nuk do të kryejë asnjë veprim që përbën shkelje apo dështim në zbatimin e ndonjë marrëveshjeje huazimi dhe nuk do t'i ndryshojë kushtet e ndonjë marrëveshjeje të tillë;

5.1.22 nuk do të kryejë asnjë veprim që përbën shkelje apo dështim në zbatim të Kontratave të Ndërlidhura, me kusht që Kontratat e Ndërlidhura në fjalë të jenë lidhur para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje; dhe

5.1.23 nuk do të ofrojë apo ndryshojë skemat e beneficioneve, bonuseve dhe opsioneve të përfitimit kapital për punonjësit;

Për qëllime të Klauzolave 5.1.1, 5.1.3 dhe 5.1.20, 'Shuma e Gjithmbarshme' do të jetë e barabartë me pesëqind mijë euro (500,000 euro), ndërsa shumat e kalkuluara sipas klauzolave të lartpërmendura nuk do të tejkalojnë përgjithësisht 'Shumën e



Gjithmbarshme'. Për qëllimet të Klauzolës 5.1, 'Materiale' do të nënkuptojë diçka me rëndësi materiale apo komerciale (qoftë në kuptim të obligimit financiar apo tjetër) në kontekst të çështjes në fjalë dhe në lidhje me transaksionin e rregulluar me këtë Marrëveshje. Shitësi zotohet se do të sigurojë se nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje deri në Përmbyllje:

5.1.24 Blerësi dhe përfaqësuesit e tij do të gëzojnë qasje të arsyeshme në të gjitha ndërtesat, asetet, librat, regjistrat dhe llogaritë e KEK-ut, përderisa kjo të jetë relevante për këtë transaksion, dhe kompania do të lejohet që të kryejë inspektime të tilla në rast se për këtë parashtrohet një kërkesë e arsyeshme nga Blerësi, dhe që atyre tu sigurohen të gjitha informatat relevante financiare dhe operative që mund të kërkohen me arsye nga Blerësi dhe përfaqësuesit e tij, me kusht që:

(a) të lejohet qasja në fjalë dhe që inspektimet të kryhen në mënyrë që nuk ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme me veprimtarinë afariste të KEK-ut, Kompanisë apo Shitësit; dhe

(b) Blerësi dhe përfaqësuesit e tij tu përmbahen në mënyrë strikte të gjitha rregulloret dhe procedurave të sigurisë në fuqi të KEK-ut, kompanisë dhe Shitësit, dhe se do të realizojë me shpejtësi të gjitha kërkesat e arsyeshme dhe udhëzimet që ua japin përfaqësuesit e tyre; dhe

(c) të mund të kufizohet qasja në zona të caktuara, për shkaqe sigurie; dhe

5.1.25 përveç në rast të domosdoshmërisë operative apo emergjencës apo rrethanave që nuk i ka nën kontroll, Kompania do të mbajë dhe zhvillojë afarizmin e vet, sipas ritmit dhe rregullave të cilave iu është përmbajtur para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, me çdo kusht, përveç rasteve kur për këtë është marrë pëlqimi me shkrim nga Blerësi. Pëlqimi i tillë nuk do të mohohet apo vonohet pa arsye dhe duhet t'u përmbahet dispozitave të përcaktuara në klauzolën 5.1.

5.2 Kompania do ta njoftojë Blerësin me shkrim mbi kohën dhe vendin e mbajtjes së takimeve të menaxhmentit dhe Bordit të kompanisë, ndërsa njoftimet e tilla (përveç në raste emergjente) duhet të pranohen jo më vonë se pesë (5) ditë pune para mbajtjes së një takimi të tillë. Të gjitha vendimet e marra në takimet e Bordit të Kompanisë do të konsiderohen të pavlefshme në rast se Blerësi nuk ka marrë njoftimin paraprak për mbajtjen e takimit të tillë së paku pesë ditë pune para mbajtjes së tij. Blerësi do të ketë të drejtë të emërojë dy vëzhgues për të marrë pjesë në takimet e tilla të menaxhmentit dhe Bordit, në kapacitetet vëzhguesish.

### ***Të drejtat e shkëputjes para Përmbylljes***

5.3 Shitësi mund të shkëpusë këtë Marrëveshje para Përmbylljes, përmes dërgimit të një njoftimi me shkrim Blerësit, nëse:

5.3.1 mbahet ndonjë takim i kreditorëve të Blerësit, me qëllim të ripërshtatjes së përgjithshme apo ripërcaktimit të orarit të kthimit të borxheve, apo çfarëdo delegimi të përgjithshëm që mund t'i sjell përfitime kreditorëve të tij; ose

5.3.2 pranuesi, administratori apo likuiduesi apo ndonjë zyrtar i ngjashëm merr në posedim apo emërohet për të menaxhuar apo ekzekutuar ndonjë proces të pavullnetshëm mbi tërë biznesin dhe asetet e Blerësit apo të ndonjë pjese të tyre; ose

5.3.3 Blerësi ndërpret apo kërcënon se do të ndërpresë afarizmin apo nuk është në gjendje t'i paguajë borxhet e veta; ose

5.3.4 në lidhje me Blerësin është paraqitur ndonjë kërkesë gjyqësore e cila mbetet e pakontestuar për një periudhë prej tridhjetë ditësh pas pranimit të njoftimit për të, apo mbahet ndonjë takim me qëllim të konsiderimit të mbylljes, falimentimit apo shpërbërjes apo në rast se ekzistojnë rrethana që do të përbënin bazë për parashtrimin e ndonjë kërkesë të tillë gjyqësore; ose

5.3.5 informatat me shkrim që i përmban, jepen apo ndërlidhen me Deklaratën e Kualifikimit dalin të mos jenë të vërteta dhe të sakta në çfarëdo aspekti material,

në të cilin rast dhe pa marrë parasysh nëse do të shkëputet kjo Marrëveshje, Shitësi do të ketë të drejtë që të inkasojë Garancinë e Tenderit, sikur edhe në rast të shfaqjes së cilësdo nga rrethanat e përcaktuara në nënklauzolat 5.4.1 deri 5.4.5 më lartë.

5.4 Nëse kjo Marrëveshje shkëputet në bazë të klauzolës 5.3, ajo (përveç klauzolës 5.4 dhe kësaj klauzole 5.5 dhe dispozitave të klauzolës 10.2) do të skadojë dhe nuk do të ketë efekt, dhe asnjë palë nuk do të mund të parashtrojë ndonjë pretendim ndaj asnjë pale tjetër në bazë të saj, përveç pretendimeve që rrjedhin nga shkelja paraprake e kësaj Marrëveshjeje.

5.5 I vetmi mjet në dispozicion të Blerësit, në rast të shkeljes së klauzolës 5.1 nga Shitësi, do të jetë kërkimi i dëmeve nga Shitësi, ndërsa Blerësi nuk do të ketë të drejtë që të anulojë apo shkëpusë këtë Marrëveshje.

## **6. Përmbyllja**

### ***Përmbyllja***

6.1 Përmbyllja do të realizohet në zyrat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, Kosovë, në datën që bie pesë [5] ditë pune pas plotësimit (apo heqjes dorë nëse kjo lejohet) të të gjitha Kushteve (apo në një kohë dhe vend për të cilin merren vesh palët). Në rastin e satisfacionit të të gjitha kushteve të arritura në ditën e përmbylljes (apo në cilëndo nga 4 ditë të punës në vijim (4) ditë pune ),kompletimi do të bëhet në datën e përmbylljes ose në datën kur palët pajtohen.

6.2 Pas përmbylljes, Shitësi dhe Blerësi do tu përmbahen obligimeve të tyre përkatëse, të cilat janë specifikuar në Shtojcën 3.

### ***Mospërmbajtja***

6.3 Nëse Blerësi dështon në çfarëdo mënyre materiale për t'iu përmbajtur obligimeve të veta në lidhje me përmbylljen, të cilat përcaktohen në klauzolën 6, në datën e specifikuar në klauzolën 6.1 Shitësi nuk do të obligohet ta realizojë shitblerjen e aksioneve sipas kësaj Marrëveshjeje dhe ka të drejtë që, pas njoftimit me shkrim:

6.3.1 ta shtyjë datën e Përmbylljes, për një datë tjetër që është jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së përcaktuar sipas klauzolës 6.1;

6.3.2 të vazhdojë me realizimin e transaksioneve të parapara me këtë Marrëveshje sa i përket shitblerjes së aksioneve, për aq sa është praktike dhe pa paragjykuar të drejtat e veta sipas kësaj Marrëveshjeje;

6.3.3 ta inkasojë garancinë e tenderit;

6.3.4 ta shkëpusë Marrëveshjen, me ç'rast:

(a) Blerësi do t'ia paguajë Shitësit një shumë ekuivalente me pesë për qind të Çmimit të Blerjes, brenda dhjetë (10) ditësh pune nga data e shkëputjes;

(b) përveç nëse kjo e drejtë është shfrytëzuar në bazë të klauzolës 6.3.3, Shitësi do të ketë të drejtë që të inkasojë garancinë e tenderit; dhe

(c) kjo Marrëveshje (përveç kësaj klauzole 6.3.4 dhe dispozitave të klauzolës 10.2) do të skadojë dhe nuk do të ketë efekt, ndërsa asnjë palë nuk do të ketë të drejtë të bëjë pretendime ndaj palëve tjera në lidhje me këtë Marrëveshje; apo

6.3.5 të heqë dorë nga disa apo të gjitha obligimet e Blerësit sa i përket përmbylljes, sipas vlerësimit të vet.

6.4 Palët pranojnë dhe pajtohen se vlerat e pagueshme sipas klauzolave 6.3.4 (a) dhe (b) përbëjnë dëme të likuiduara dhe jo ndëshkime. Paguesa e plotë dhe e saktë nga Blerësi, në pajtim me klauzolën 6.3.4 do të përbëjë të vetmin mjet dhe masë të dëmeve në lidhje me çështjet që përbëjnë arsyen për pagimin e tyre.

### ***Efkti i përmbylljes***

6.5 Përkundër përmbylljes:

6.5.1 të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje (dhe të dokumenteve të tjera të cilat përmenden në të) të cilat nuk janë realizuar para Përmbylljes, e të cilat mund të kryhen;

6.5.2 Garancitë, dhe

6.5.3 të gjitha zotimet dhe obligimet në të cilat është hyrë përmes kësaj Marrëveshjeje, do të mbeten në fuqi dhe do të kenë efekt të pakufizuar kohor (përveç nëse përcaktohet ndryshe).

## **7. Transferimi i asetëve**

Marrëveshja e Transferimit, e dhënë në Shtojcën 6, do të përbëjë bazën për transferimin e asetëve dhe punonjësve nga KEK-u tek Kompania.

## **8. Garancitë**

### ***Garancitë***

8.1 Shitësi i garanton Blerësit kushtet e përcaktuara në Shtojcën 4, sa i përket kompanisë. Çdo garanci e përcaktuar në paragrafët e ndryshëm të Shtojcës 4 do të jetë e ndarë dhe e pavarur dhe (përveç nëse është rregulluar shprehimisht ndryshe) nuk do të kufizohet duke iu referuar ndonjë Garancie tjetër apo ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje apo të Marrëveshjes për Zbulim të Informatave.

8.2 Blerësi me këtë rast garanton Shitësin në kuptim të kushteve të dhëna në Shtojcën 4.

### ***Hetimet nga Blerësi***

8.3 Asnjë nga garancitë nuk do të mund të konsiderohet se është modifikuar apo realizuar si rrjedhojë e hetimeve apo kërkimeve të bëra apo që do të bëhen nga Blerësi, apo në emër të tij. Asnjë informatë që ka të bëjë me Kompaninë dhe/ose KEK-un që nuk është zbuluar, e për të cilën Blerësi ka njohuri (qoftë aktuale apo e konstruktuar), nuk mund të shfrytëzohet për të paragjykuar pretendimet të cilat Blerësi do të ketë të drejtë t'i bëjë, apo të shfrytëzohet për të zvogëluar vlerën që Blerësi mund ta rikuperojë sipas kësaj Marrëveshjeje.

### ***Informatat e ofruara nga Kompania***

8.4 Shitësi i garanton Blerësit se do të heqë dorë nga të gjitha pretendimet (përfshirë ato për neglizhencë) të cilat Shitësi mund t'i ushtrojë ndaj Kompanisë dhe zyrtarëve, punonjësve, agjentëve apo konsulentëve të saj, sa u përket të gjitha informatave që këta persona mund të kenë në kapacitetet e tyre pranë Shitësit, në lidhje me Garancitë dhe informatat e zbuluara.

### ***Varshmëria***

8.5 Shitësi pranon se Blerësi është ftuar për të lidhur këtë Marrëveshje, dhe se i njëjti e ka lidhur atë në bazë dhe duke u mbështetur në Garancitë.

## **9. Kufizimi i përgjegjësisë së Shitësit**

### ***Kufizimet e përgjegjësisë***

9.1 Përgjegjësia e Shitësit sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me Garancitë në fjalë do të kufizohet në pajtim me Shtojcën 5.

### ***Përjashtimet nga klauzola 9***

9.2 Pa paragjykuar dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Klauzole 9 dhe të Shtojcës 5 nuk do të zbatohen në rastet kur ndaj Shitësit bëhen pretendime për arsye të falsifikimit, mossinqeritetit, deklarimit të rrejshëm apo lëshimit të qëllimtë nga Shitësi apo në emër të tij.

### ***Hetimi i pavarur***

9.3 Blerësi e kupton dhe pajtohet se, përveç Garancive të Shitësit, Shitësi nuk do të japë kurrfarë garanci sa i përket saktësisë së parashikimeve, supozimeve, projeksioneve, deklaratave të qëllimit apo deklaratave mbi opinionet e dhëna Blerësit deri më datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje apo në dokumentet të cilat i janë dorëzuar Blerësit apo këshilltarëve të tyre përkatës (përfshirë dokumentet që gjenden në Dhomën e të Dhënave).

9.4 Blerësi konfirmon se ka kryer hetim, inspektim, analizë dhe vlerësim të pavarur të tij në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me afarizmin e Kompanisë dhe afarizmit të KEK-ut, në lidhje me transaksionin e paraparë me këtë Marrëveshje, përfshirë:

9.4.1 afarizmin, asetet dhe obligimet e (i) Kompanisë dhe (ii) KEK-ut, përderisa afarizmi, asetet dhe përgjegjësitë në fjalë ndërlidhen me transaksionin e paraparë me këtë Marrëveshje;

9.4.2 regjimin rregullativ të sektorit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, të cilit do t'i nënshtrohet Kompania;

9.4.3 vetë Republikën e Kosovës;

9.4.4 pasojat ligjore, financiare dhe tatimore nga lidhja e kësaj Marrëveshjeje; dhe

9.4.5 dispozitat e të gjitha rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të marra nga ZRRE dhe të gjitha implikacionet përkatëse të tyre,

dhe se ka lidhur këtë Marrëveshje në bazë të hetimeve, inspektimeve, analizave dhe vlerësimeve në fjalë dhe jo duke u bazuar në informatat apo prezantimet të cilat mund t'i jenë bërë nga Shitësi, MZHE, ZRRE apo Kompania, apo nga zyrtarët, punonjësit, konsulentët apo këshilltarët e tyre.

9.5 Blerësi pranon se:

9.5.1 pa paragjykuar Garancitë e Shitësit sipas Shtojcës 4, është i kënaqur me gjendjen dhe konditat e asetëve, pa marrë parasysh gjendjen e asetëve në fjalë dhe se do t'i blejë ato me gjithë gjendjen teknike, strukturore apo të ngjashme që mund t'i kenë, qoftë ajo patente apo latente;

9.5.2 nuk është duke lidhur këtë Marrëveshje si rrjedhojë apo duke u bazuar në komunikim apo shpallje të cilat nuk janë bërë në mënyrë të ligjshme, në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës (apo ligjeve të zbatueshme nën juridiksionin e domicilit të Blerësit) nga shitësi apo këshilltarët profesionalë të tij.

## **10. Shkëputja**

### ***Obligimet e grumbulluara***

10.1 Pas shkëputjes, të drejtat dhe obligimet e palëve të cilat janë shfaqur para shkëputjes do të vazhdojnë të mbesin në fuqi.

### ***Dispozitat mbijetuese***

10.2 Kjo klauzolë dhe dispozitat vijuese të kësaj Marrëveshjeje do t'i mbijetojnë shkëputjes së saj, pa kufizim kohor:

10.2.1 Klauzola 1; dhe

10.2.2 Klauzolat 8 deri në 28 (përfshirë këtë të fundit).

## **11. Siguria e mëtejme**

11.1 Palët kohë pas kohe do të sajojnë akte dhe/apo do të nënshkruajnë dokumente të cilat palët me arsye konsiderojnë se i japin efekt të plotë kësaj Marrëveshjeje (apo pjesëve të saj që mbesin efektive edhe pas shkëputjes).

11.2 Pas Përmbylljes, Blerësi do të përpiqet për aq sa është e arsyeshme që të pajtohet për kushtet komercialisht të pranueshme në mënyrë që Kompania të lidhë marrëveshje për blerje të energjisë me kompaninë e cila nga QK është përzgjedhur për të ndërtuar dhe operuar me stabilimentet e reja gjeneruese të cilave aktualisht ju referohet si GenCo.

## **12. Konfidencialiteti dhe publiciteti**

Palët pajtohen se kjo Marrëveshje do të jetë dokument në dispozicion të publikut.

## **13. Delegimi**

Përveç nëse kjo është përcaktuar në Marrëveshjen e Implementimit, asnjëra palë nuk mund të delegojë apo transferojë përfitimet nga kjo Marrëveshje, qoftë në mënyrë absolute apo përmes letrave me vlerë, pa pëlqim paraprak me shkrim nga pala tjetër, dhe çfarëdo delegimi në kundërshtim me këtë klauzolë do të konsiderohet i pavlefshëm.

## **14. Heqja dorë; variacionet; pavlefshmëria**

### ***Mos-heqja dorë për shkak të lëshimit, vonesës apo ushtrimit të pjesshëm***

14.1 Nga asnjë e drejtë, autorizim apo mjet juridik i siguar me ligj apo në bazë të kësaj Marrëveshjeje nuk do të hiqet dorë, nuk do të pengohet apo përjashtohet si rezultat i vonesës apo lëshimit në ushtrimin e tyre, nga ushtrimi i tyre i plotë apo i pjesshëm më parë, apo nga vonesat apo lëshimet në ushtrimin e tyre, apo nga ushtrimi i pjesshëm apo i plotë i të drejtave, autorizimeve apo mjeteve juridike të tilla.

### ***Heqja dorë të bëhet specifikisht me shkrim***

14.2 Heqja dorë nga çfarëdo e drejte, autorizimi apo mjete juridik të siguar përmes kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim dhe mund të jepet vetëm në bazë të kushteve përkatëse të përcaktuara nga dhënësi. Asnjë heqje dorë nuk do të jetë e zbatueshme nëse personi që kërkon heqjen dorë ka dështuar që t'ia zbulojë dhënësit faktet materiale apo rrethanat të cilat (për aq sa është në dijeni personi që kërkon heqjen dorë) kanë ndikim në temën në fjalë. Përveç në rastet kur rregullohet ndryshe në mënyrë shprehimore, heqja dorë do të jetë e zbatueshme vetëm në rastin në fjalë dhe vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë.

### ***Variacionet të bëhen me shkrim***

14.3 Asnjë variacion i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ketë efekt nëse nuk arrihet me shkrim dhe nëse nuk nënshkruhet nga të dyja palët.

### ***Pavlefshmëria***

14.4 Të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje duhet konsideruar në mënyrë individuale. Nëse cilado dispozitë është apo bëhet e pavlefshme, joligjore apo e pazbatueshme sipas ligjit të një juridiksioni, atëherë ajo nuk do të ndikojë apo pengojë ligjshmërinë, vlefshmërinë apo

zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje në të njëjtin juridiksion, apo të cilësdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje në ndonjë juridiksion tjetër. Në rast se ndonjë term shfuqizohet, bëhet i paligjshëm apo i pazbatueshëm, Palët do të takohen sa më shpejt që të jetë e mundur për tu pajtuar mbi mënyrën përkatëse të veprimit e cila iu shërben qëllimeve të Palëve të cilat përcaktohen me këtë Marrëveshje.

## **15. Kostot dhe shpenzimet**

### ***Mbulimi i kostove***

15.1 Përveç në rastet e rregulluara ndryshe me këtë Marrëveshje, secila palë do të mbulojë kostot dhe shpenzimet e veta që ndërlidhen me negocimin, përgatitjen, lidhjen apo vënien në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, apo të marrëveshjeve të tjera të cilat përbëjnë pjesë të transaksionit të rregulluar me këtë Marrëveshje.

15.2 Blerësi do të jetë përgjegjës dhe do t'ia paguajë Këshilltarit të Transaksionit Kostot e Transaksionit brenda dhjetë (10) ditësh pune nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

## **16. Pagesat**

### ***Moszbritja e çmimit, etj.***

16.1 Përveç në rastet kur shprehimisht përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, të gjitha pagesat që duhet të bëhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje do bëhen të plota pa kurrfarë ndërhyrje apo kundërpretendimi dhe pa kurrfarë zbritje apo ndalesë, përveç nëse kjo kërkohet me ligj (e në të cilin rast zbritja apo ndalesa nuk do të tejkalojë shumën minimale të kërkuar me ligj, ndërsa që paguesi do t'ia paguajë pranuesit të pagesës tërë shumën e kërkuar shtesë për të arritur shumën neto të barabartë me shumën e pagueshme në rast se nuk do të kërkohet zbritja apo ndalesa në fjalë). Të gjitha shumat e pagueshme në lidhje me Garancitë, dëmshpërblimet apo obligimet do të shtohen në nivel të domosdoshëm për të siguruar se vlera neto e pranuar nga Blerësi pas tatimit do të jetë e barabartë me vlerën e cila do të pranohej në rast se pagesa nuk do të ishte tatuar.

### ***Interesi për vonesë në pagesa***

16.2 Nëse ndonjëra palë nuk paguan shumat e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje deri në datën e paraparë për pagesë, ajo do të paguajë interes (kamatë) në shumën në fjalë për periudhën mes datës së paraparë për pagesë dhe datës së kryerjes së pagesës (pas dhe para aktgjykimit), sipas normës së dështimit. Interesi do të mblidhet në baza ditore për secilën ditë të kaluar, ndërsa viti prej 365 ditësh do të paguhet në bazë të kërkesës dhe do të grumbullohet në baza mujore.



## **17. Tërësia e marrëveshjes**

### ***Kjo marrëveshje***

17.1 Në këtë klauzolë, referencat ndaj kësaj Marrëveshjeje përfshijnë edhe marrëveshjet tjera me shkrim dhe aranzhimet mes Palëve, si dhe të gjithë instrumentet që është thënë se përbëjnë shtesë të kësaj Marrëveshjeje, apo të cilët kjo Marrëveshje kërkon nga palët që tu përmbahen apo t'i realizojnë.

### ***Tërësia e marrëveshjes***

17.2 Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë dhe të vetme për të cilën palët kanë arritur pajtimin në lidhje me temën në fjalë. Në pajtim me nënklauzolën 17.4, të gjitha draftet e mëparshme, marrëveshjet, pëlqimet, obligimet, përfaqësimet, garancitë, premtimet apo aranzhimet e çfarëdo natyre mes palëve që mund të jenë bërë në lidhje me temën e cila rregullohet me këtë Marrëveshje do të shfuqizohen dhe do të shuhen, përveç në rastet kur kushtet në fjalë janë riprodhuar apo pasqyruar si të tilla në këtë Marrëveshje.

### ***Mjetet tjera juridike***

17.3 Të drejtat, autorizimet dhe mjetet juridike të ofruara sipas kësaj Marrëveshjeje janë të pavarura dhe kumulative dhe nuk përjashtojnë të drejtat, autorizimet apo mjetet juridike (të shprehura apo të nënkuptuara) të cilat vihen në dispozicion me ligj, statut, zakon apo në forma tjera.

### ***Falsifikimi***

17.4 Asnjë pjesë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të duhej lexuar apo kuptuar si përjashtim i përgjegjësive apo obligimeve në lidhje me falsifikimin.

## **18. Pjesët e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje mund të lidhet e ndarë në disa pjesë, ndërsa palët mund të nënshkruajnë kopje të ndryshme të saj. Të gjitha pjesët e saj do të përbëjnë version origjinal të kësaj Marrëveshjeje, por të gjitha pjesët dhe kopjet e saj së bashku do të përbëjnë një Marrëveshje të vetme.

## **19. Njoftimet**

### ***Forma e njoftimeve***

19.1 Çdo komunikim që bëhet në lidhje me çështjet e rregulluara me këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur shprehimisht është rregulluar ndryshe, do të bëhen me shkrim dhe do të dorëzohen me dorë apo me postë të parapaguar të klasit të parë, apo me telefaks. Dorëzimi i njoftimeve nga korrieri do të konsiderohet si dorëzim në dorë.

### ***Adresa dhe faksimili***

19.2 Komunikimi do të bëhet përmes adresave të palëve përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, apo numrit të faksimilit të përcaktuar më poshtë, ose në adresat dhe numrat e faksimilit të cilat palës dërguese i janë komunikuar paraprakisht, në pajtim me këtë Klauzolë. Çdo komunikim do t'i dërgohet për vëmendje të një personi relevant.

Shitësi – numri i faksimilit +381-38-213955. Për vëmendje të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik

Blerësi – numri i faksimilit +381-38-609258. Për vëmendje të Z.Mesut Serhat Dinc, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm, Energy Grpoup.

### ***Koha e dorëzimit***

19.3 Komunikimi do të konsiderohet se është dorëzuar:

19.3.1 në kohën e dorëzimit, nëse dorëzimi bëhet në dorë në adresën e përcaktuar në nënklauzolën 19.2;

19.3.2 në momentin e skadimit të dy ditëve të plota pas dorëzimit në postë, në rast se komunikimi bëhet përmes postës së parapaguar të klasit të parë në adresën të cilës i referohet ajo nënklauzolë; dhe

19.3.3 në momentin e kompletimit të transmisionit nga dërguesi, në rast se komunikimi bëhet përmes faksimilit në numrin të cilit i referohet në atë nënklauzolë.

Nëse komunikimi mund të konsiderohet se është realizuar jashtë orarit të zakonshëm të punës (mes 08:00 dhe 16:00 gjatë ditëve të punës) në zonën kohore të territorit të pranuesit sipas dispozitave paraprake të kësaj Klauzole, ai do të konsiderohet se është pranuar gjatë ditës së parë vijuese të punës në territorin e pranuesit.

### ***Dëshmia e pranim-dorëzimit***

19.4 Për të dëshmuar pranim-dorëzimin e komunikimit, duhet të dëshmohet se është kryer dorëzimi në pajtim me ligjet e Kosovës.

### ***Ndryshimi i detajeve***

19.5 Palët mund ta njoftojnë tjetrën mbi ndryshimin e emrit, personit relevant, adresës apo numrit të faksimilit për qëllimet e nënklauzolës 19.2, me kusht që njoftimet në fjalë të hyjnë në fuqi:

19.5.1 në datën e specifikuar në njoftim si data në të cilin ndryshimi hyn në fuqi; ose

19.5.2 në rast se nuk specifikohet ndonjë datë, apo në rast se data është më pak se pesë (5) ditë të plota pune pas datës në të cilën njoftimi konsiderohet se është dërguar, data e cila bie pesë (5) ditë të plota pune pas datës së pranimit të njoftimit në fjalë do të konsiderohet si datë në të cilën ai hyn në fuqi.

### ***Moszbatueshmëria në rastin e procedurave***

19.6 Për të shmangur çfarëdo dyshimi, palët pajtohen se dispozitat e kësaj klauzole nuk do të zbatohen në lidhje me dërgimin e çfarëdo kërkesë apo pretendimi, njoftimi për kërkesë, urdhri, aktgjykimi apo dokumenti tjetër që ka të bëjë me çfarëdo procedure.

## **20. Tatimimi**

Të zbatueshme do të jenë tatimet e Kosovës të përcaktuara me ligj.

## **21. Financimi i jashtëm; valutat e huaja dhe riatdhesimi i mjeteve**

21.1 Shitësi nuk do t'ia ndalojë Blerësit pranimin e fondeve të ndërlidhura me investimin e tij në Kompani nga jashtë Kosovës, në rast se ato do të shfrytëzohen për të financuar afarizmin e Kompanisë.

21.2 Shitësi do t'i lejojë Blerësit transferimin brenda dhe jashtë Kosovës, në valutë të huaj (përfshirë pa kufizime dollarët amerikanë dhe euron), të gjitha shumat e fituara nga afarizmi i Kompanisë. Blerësi do të ketë të drejtë të riatdhesojë pagesat e interesit, riparimin e huave, dividendët dhe shpërndarjet tjera të bëra nga Kompania apo në emër të saj, në çdo kohë dhe pa tatimim shtesë që do paguhej nga Blerësi.

21.3 Shitësi do të lejojë riatdhesimin e pagesave të interesit, kësteve të kredive, dividendëve dhe shpërndarjeve të tjera nga Blerësi, të cilat bëhen për kompaninë apo në emër të Kompanisë, në çdo kohë dhe pa tatimim shtesë që do paguhej nga Blerësi.

## **22. Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni**

### ***Ligjet e Kosovës***

Kjo Marrëveshje, dhe të gjitha të drejtat dhe obligimet jokontraktuese që rrjedhin apo ndërlidhen me temën në fjalë, do të udhëhiqen dhe do të kuptohen në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës.

## 23. Zgjidhja e kontesteve

23.1 Në rast se mes palëve shfaqet çfarëdo kontesti në lidhje me këtë Marrëveshje (në tekstin e mëtejshëm 'Kontesti') palët në kontest mund të kërkojnë përmes njoftimit me shkrim nga pala tjetër në kontest që çështja t'i delegohet një përfaqësuesi të caktuar të Shitësit dhe një përfaqësuesi të caktuar të Blerësit, të cilët do përpiqen që kontestin ta zgjidhin me diskutim brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dorëzimit të njoftimit në fjalë nga njëra Palë tek Pala tjetër.

23.2 Çdo kontest, dallim, kundërtënie apo pretendim që rrjedh apo ndërlihet me këtë Marrëveshje, apo me shkeljen, shkelputjen apo pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht me arbitrazh, në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL), të cilat janë të zbatueshme për momentin, apo, në rast se rregulla të caktuara të zbatueshme të arbitrazhit të UNCITRAL-it për çështjen në fjalë janë përjashtuar përmes kësaj Marrëveshjeje, në bazë të së drejtës procedurale të Zvicrës, me kusht që:

23.2.1 deklarata mbi pretendimin dhe njoftimi mbi emërimin e arbitrit të përfshihen në njoftimin e arbitrazhit;

23.2.2 autoriteti emëruar do të jetë Presidenti i Odës Tregtare të Gjenevës; numri i arbitrave do të jetë 3 (tre);

23.2.3 vendi i arbitrazhit do të jetë Gjeneva, Zvicër;

23.2.4 gjuha e zhvillimit të procedurës së arbitrazhit do të jetë gjuha angleze;

23.2.5 neni 22 i Rregullave të UNCITRAL-it nuk do të zbatohet dhe palët nuk do të lejohen që të ndryshojnë apo plotësojnë deklaratën e tyre të pretendimeve apo deklaratën mbrojtëse përveç nëse pala tjetër pajtohet me shkrim, apo nëse gjykata e arbitrazhit e konsideron si adekuate që të lejojë ndryshimin apo plotësimin në fjalë, duke marrë parasysh vonesat në sajimin e saj dhe çdo lloj paragjykimi që mund t'i shkaktohet palës tjetër apo rrethanat tjera relevante;

23.2.6 secila palë mund të kërkojë dëgjim gojor, por gjykata e arbitrazhit e themeluar në pajtim me këtë klauzolë 23.2 (në tekstin e mëtejshëm 'Gjykata e Arbitrazhit') do të mund të nxjerr vendim diskrecional nëse dëgjimi i tillë do të mbahet, përveç nëse kjo kërkesë përkrahet edhe nga pala tjetër;

23.2.7 Gjykata e Arbitrazhit nuk do të jetë e autorizuar që të vendosë në kapacitetin e "*amiables compositeurs*" apo "*ex aequo et bono*" apo të zbatojë nenin 27, paragrafi 3, apo nenin 29, paragrafi 2 të Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL, në rast se dispozitat në fjalë kanë të bëjnë me inspektimin apo sajimin e dokumenteve. Gjykata e Arbitrazhit mund të kërkojë nga palët parashtrimin e dokumenteve, dëshmimeve dhe provave të tjera të cilat Gjykata e Arbitrazhit i

konsideron relevante, brenda orarit kohor të cilin ajo e cakton. Nëse një palë që bartë barrën e së provuarit të fakteve të cilat e përkrahin pretendimin apo mbrojtjen e saj nuk dëshiron të zbulojë dokumentet, dëshmitë apo provat në fjalë, atëherë Gjykata e Arbitrazhit do të jetë e lirë që të shqyrtojë nëse të gjitha faktet dhe rrethanat janë dëshmuar apo jo;

23.2.8 neni 37 dhe neni 39 i Rregullave të Arbitrazhit të UNICTRAL nuk do të zbatohen;

23.2.9 Gjykata e Arbitrazhit nuk do të ketë të drejtë që të nxjerrë vendime të pjesshme apo vendime të përkohshme me masat që rregullohen në nenin 26 të Rregullave të UNCITRAL; dhe

23.2.10 vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit të jetë përfundimtar dhe obligues për palët, me kusht që:

(a) paragrafët (a), (b) dhe (d) të nenit 190 (2) të Ligjit Federal Zviceran për të Drejtën Ndërkombëtare Private të jenë të zbatueshëm; dhe

(b) paragrafi (c) i nenit të lartpërmendur 190 (2) të jetë i zbatueshëm vetëm për veprimet për ndarjen e pjesës nga vendimi i marrë që konsiderohet se tejkalon pretendimet e parashtruara para Gjykatës së Arbitrazhit; në asnjë aspekt tjetër nuk mund të iniciohen veprime për të ndarë vendimin e nxjerrë në pajtim me paragrafin e lartpërmendur (c).

23.3 Zbatimi i vendimit në fjalë mund të duhet të kryhet nga gjykata kompetente. Përveç në raste të tilla, përjashtohen të gjitha të drejtat e ankimit, anulimit apo kërkimit pranë gjykatave të rregullta të çfarëdo të drejte të ndërlidhur me këtë marrëveshje, me arbitrazhin që zhvillohet në pajtim me të apo me vendimin që nxirret më pas.

23.4 Palët kuptojnë dhe pranojnë se kjo Marrëveshje përbën një transaksion komercial, në lidhje me të cilin asnjëra palë nuk ka të drejtë të thirret në imunitet sovran, ndërsa Shitësi dhe Blerësi me këtë rast heqin dorë në mënyrë të parevokueshme nga imuniteti sovran në rast të çfarëdo veprimi që nxit arbitrazhin sipas kësaj Marrëveshjeje, apo në ekzekutimin apo zbatimin e vendimeve të marra në procedura të arbitrazhit, të zhvilluara në bazë të kësaj saj.

23.5 Vendimi i nxjerrë përmes arbitrazhit të zhvilluar në pajtim me këtë nen, apo i urdhrave (përfshirë urdhrat e përkohshëm) të nxjerrë nga gjykata kompetente në pajtim me të drejtën e zbatueshme dhe në lidhje me çështjet paraprake të kontestit të shfaqur pas përfundimit të procedurave të arbitrazhit, mund të paraqiten para çdo gjykate që bartë juridiksion për zbatimin e tyre.

23.6 Asnjëra palë në kontest nuk do të ketë të drejtë që të iniciojë apo ngrisë padi apo procedura ligjore lidhur me ndonjë kontest që zhvillohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje, në gjykata të Kosovës apo jashtë saj, derisa për kontestin të jetë vendosur në pajtim me procedurën e arbitrazhit e cila është e përcaktuar me këtë rast, kur mund të kërkohet nga gjykata zbatimi apo mundësimi i ekzekutimit të vendimit të nxjerrë në arbitrazh.

23.7 Gjatë zhvillimit të arbitrazhit në bazë të kësaj Marrëveshjeje:

23.7.1 Shitësi dhe Kompania do të vazhdojnë të kryejnë obligimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

23.7.2 as Kompania as Shitësi nuk do të shfrytëzojnë mjetet tjera juridike në dispozicion në lidhje me çështjet që shfaqen si kontestuese.

23.8 Çdo vendim i nxjerrë përmes arbitrazhit të zhvilluar sipas kësaj Marrëveshjeje do të përbëjë ‘vendim të huaj’, sipas kuptimit të Konventës së Nju Jorkut mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit dhe Zbatimin e Aktgjykimeve të Huaja, Ligji nr. 08, i vitit 1952.

## **24. Zbatimi**

24.1 Duke marrë parasysh të drejtën në ankesë, në ankesë të dytë, në revizion apo në procedura ose mjete të tjera ligjore të ofruara me ligj, Blerësi dhe Kompania pranojnë të zbatojnë të gjitha aktgjykimet përfundimtare të nxjerra në procedura të rregullta në Kosovë apo jashtë dhe të lehtësojnë proceset që zhvillohen në lidhje me procedurat e tilla (përfshirë nxjerrjen, zbatimin apo ekzekutimin apo ofrimin e çfarëdo prone, pa marrë parasysh destinimin e paraparë të saj, përfshirë pronën që ndodhet jashtë Kosovës).

24.2 Duke marrë parasysh të drejtën në ankesë, në ankesë të dytë, në revizion apo në procedura ose mjete të tjera në ligjore të cilat Shitësi i ka në dispozicion sipas ligjit, Shitësi obligohet të zbatojë të gjitha aktgjykimet përfundimtare kundër tij të nxjerra në procedura të zhvilluara qoftë në Republikën e Kosovës qoftë jashtë saj, në pajtim me dispozitat e zbatueshme të ligjit.

## **25. Marrëdhënia mes palëve**

25.1 Kjo Marrëveshje nuk krijon ndonjë shoqëri, ndërmarrje të përbashkët apo ndonjë partneritet mes palëve.

25.2 Asnjëra palë nuk ka të drejtë, autoritet apo autorizime për të hyrë në ndonjë marrëveshje apo obligim për palën tjetër, për të vepruar në emër të saj, apo për të qenë agjent apo përfaqësues i saj, apo për ta obliguar atë në çfarëdo mënyre.

## **26. Aktet sovrane dhe imuniteti**

Shitësi në mënyrë të pakushtëzuar dhe të përvokueshme, deri në masën maksimale të lejuar me ligj:

26.1.1 pajtohet se ekzekutimi, sigurimi dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje nga ana e tij nuk përbën akt sovran;

26.1.2 pajtohet se në rast se shfaqet ndonjë procedurë në lidhje me këtë Marrëveshje apo për transaksionet që kjo Marrëveshje i parasheh nuk do të pretendohet kurrfarë imuniteti sovran ndaj procedurave të tilla, të cilat do të mund t'i shfrytëzonte përndryshe sipas ligjeve të Republikës së Kosovës nga ai apo nga palët tjera në emër të tij; dhe

26.1.3 deri në masën maksimale të lejuara me ligj, heq dorë nga e drejta e imunitetit sovran, të cilat aktualisht i gëzon ai apo subjektet e ndërlidhura me të, apo që mund t'i gëzojë në të ardhmen.

## **27. Mirëbesimi**

Palët garantojnë se do të veprojnë në mirëbesim sa i përket realizimit dhe implementimit të kësaj Marrëveshjeje dhe të ndërmarrin masat tjera të arsyeshme të cilat mund të jenë të domosdoshme për të realizuar qëllimet e saj.

## **28. Pagesat joadekuate**

28.1 Secila palë i garanton palës tjetër se ajo, dhe bashkëpunëtorët e saj dhe zyrtarët, menaxherët, drejtorët, punonjësit, aksionarët, anëtarët, agjentët, kontraktorët dhe përfaqësuesit e saj, qoftë duke vepruar vetë apo në emër të palës apo përmes palës së tretë, nuk do të ofrojnë, japin, paguajnë, premtojnë se do të japin apo paguajnë, nuk do të japin autorizim për të ofruar, dhënë, paguar apo premtuar pagimin e parave, dhuratave, mitos, huave, komisionit, pagesës (përfshirë pagesat për këshillim apo pagesat e agjentëve), shpërblimit, avantazhit apo të mirave të tjera që mund të kenë vlerë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për cilindo Zyrtar (sipas përkufizimit të mëposhtëm), apo personave të tjerë duke e ditur se ato do t'i ofrohen, jepen apo premtohen Zyrtarit, në mënyrë të paligjshme, apo në natyrë të mitos, pagesës për ndikim apo me qëllim të ngjashëm të fshehur, apo me qëllim të ndikimit në ndonjë veprim apo vendim zyrtar të Zyrtarit, përfshirë kërkimin nga Zyrtari në fjalë që të kryejë veprime apo mosveprime që përbëjnë shkelje të detyrave ligjore të tij, apo cytjen e Zyrtarit në fjalë për të ndikuar tek Shitësi, apo çfarëdo instrumentalizimi për të ndikuar në veprimet apo vendimet e Shitësit, me qëllim që cilësdo palë t'i ndihmohet në afarizmin e saj. Për qëllime të klauzolës 28, fjala 'Zyrtar' do të thotë (i) çdo zyrtar apo punonjës i Shitësit, departamentit (ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor apo administrativ), agjencisë apo organeve të Shitësit, përfshirë edhe organet qeverisëse regjionale dhe ndërmarrjet në pronë të qeverisë, apo organizatat publike ndërkombëtare; (ii) çdo person që vepron në kapacitet zyrtar për Shitësin apo në emër të tij, apo për ndonjë departament, organ apo organizatë publike të tij; (iii) çdo kandidat për poste zyrtare; dhe (iv) çdo parti politike nga Republika e Kosovës ose nga jashtë.

28.2 Në rast se Blerësi kryen ndonjë shkelje të Klauzolës 28, të cilën shkelje (të riparueshme) nuk e riparon në mënyrë të kënaqshme për Shitësin brenda dhjetë (10) ditësh pas pranimi nga Blerësi apo Kompania të njoftimit me shkrim nga Shitësi në të cilin përcaktohet shkelja e kryer nga Blerësi apo Kompania (sipas rastit), Shitësi ka të drejtë diskrecionale:

28.2.1 që të shkëpusë këtë Marrëveshje, duke i dërguar Blerësit dhe Kompanisë njoftim përkatës me shkrim, dhe/ose

28.2.2 që të kërkojë nga Blerësi që të paguajë një shumë të barabartë me dyfishin e vlerës së pagesave që janë bërë apo nuk janë zbuluar, në kundërshtim me këtë klauzolë 28, pa paragjykuar mjetet tjera ligjore në dispozicion sipas kësaj Marrëveshjeje apo ligjit.

28.3 Dispozitat e kësaj klauzole 28 do të zbatohen edhe pas shkëputjes së Marrëveshjes.

**DUKE VËRTETUAR SI MË SIPËR**, Palët kanë lidhur këtë Marrëveshje në datën e përcaktuar më lartë.

## **QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

-----  
**Emri: Z.Besim Beqaj**

**Ministër, Ministria e Zhvillimit Ekonomik**

**Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A.**

-----  
**Emri: Ismail Ergünes**

**Anëtar Ekzekutiv i Bordit , Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A.**

-----  
**Emri: Nurettin Türkoğlu**

**Kryesues i Bordit Ekzekutiv, Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A.**



---

**Emri: Nihat Özdemir**

**Kryesues i Bordit, Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A.**

## Shtojca 1

### Përkufizimet dhe interpretimi

#### Pjesa 1

#### Përkufizimet

“**Bashkëpunëtor**” nënkupton çdo person, çdo subjekt (X) nën kontrollin e entitetit tjetër (Y); për qëllime të këtij përkufizimi ‘kontroll’ do të nënkuptojë rastet kur (i) Y ka në pronë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë më shumë se gjysmën e votave në X; apo (ii) edhe nëse Y ka në pronë gjysmën apo më pak të drejtave votuese në X, ndërsa Y ka pushtet direkt apo të tërthortë, për të: (a) udhëzuar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës në X, përmes një marrëveshjeje me një investitor tjetër, (b) udhëhequr politikën financiare dhe operative të X përmes statutit apo një marrëveshjeje, (c) emëruar apo larguar shumicën e anëtarëve të bordit të drejtorëve apo strukturës ekuivalente udhëheqëse të tij, ose (d) grumbulluar shumicën e votave në takimin e bordit të drejtorëve apo në organin ekuivalent, por ky përkufizim nuk do të përfshijë Kompaninë në rastin e Blerësit;

“**Marrëveshje**” do të thotë kjo marrëveshje, përfshirë Shtojcat;

“**Gjykata e Arbitrazhit**” ka kuptimin që i është dhënë në klauzolën 23.2.6;

“**Asete**” janë të gjitha asetet materiale, të prekshme dhe të paprekshme, të domosdoshme për operimin adekuat të afarizmit të Kompanisë, të cilat do t’i barten Kompanisë në pajtim me Marrëveshjen e Transferimit;

“**Garancia e tenderit**” do të thotë garancia që ofrohet nga Blerësi, në pajtim me Rregullat e Ofertimit;

“**Rregullat e ofertimit**” nënkuptojnë të rregullat e ofertimit të nxjerra nga Komiteti i Privatizimit, për të siguruar një proces konkurrues të tenderimit për privatizimin e Kompanisë;

“**Bordi**” do të thotë bordi i drejtorëve të Kompanisë aktuale;

“**Buxheti**” do të thotë lista e shpenzimeve kapitale potenciale, në formën e parapërcaktuar;

“**Marrëveshja e Furnizimit me Shumicë**” do të thotë marrëveshja për furnizim me shumicë, në formën për të cilën kanë arritur pajtimin KEK dhe KEDS;

“**Ditë pune**” nënkupton çdo ditë (përveç të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare) në të cilat bankat janë të hapura për punë në Republikën e Kosovës, në Londër dhe në Nju Jork;

**“Marrëveshja për inkasim”** nënkupton marrëveshjen për inkasim të lidhur mes Kompanisë dhe KEK-ut, në formën e përcaktuar në Shtojcën 7;

**“Kompani”** ka kuptimin e dhënë në dispozitat fillestare, detajet shtesë të së cilës janë dhënë në Pjesën 1 të Shtojcës 2;

**“Autoriteti kompetent”** do të thotë (i) çdo person (autonom ose jo) që ka autoritet ligjor dhe/ose autoritet rregullativ dhe/ose fuqi zbatuese (përfshirë autoritetet licencuese që ushtrojnë autorizime ligjore); (ii) çdo gjykatë apo tribunal të cilitdo juridiksion; dhe/ose (iii) të gjitha autoritetet tatimore;

**“Përmbyllje”** do të thotë përmbyllja e shitblerjes së aksioneve, në pajtim me klauzolën 6;

**“Data e përmbylljes”** do të thotë data në të cilën përmbyllet procesi;

**“Kushtet”** janë kushtet e përcaktuara në klauzolën 4.1;

**“Kontratat e ndërlydhura”** nënkuptojnë:

(a) Marrëveshjen për Furnizim me Shumicë;

(b) Marrëveshja e Implementimit; dhe

(c) Marrëveshja për Furnizim nga Importi;

**“Humbjet konsekuente”** nënkuptojnë të gjitha humbjet, kostot dhe dëmet financiare sa i përket humbjeve kontraktuale, humbjes së makinerisë apo pronës, humbjes së prodhimtarisë, profitit apo të ardhurave apo humbjeve të tjera ekonomike, kostove apo pretendimeve të çfarëdo natyre apo lloji të palës në lidhje me këtë Marrëveshje (përfshirë dështimin e ndonjë pale tjetër apo shkeljen e detyrave ligjore nga ndonjë palë tjetër, qoftë kjo e parashikueshme apo jo në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje);

**“Konsorciumi”** – nënkupton konsorciumin e themeluar nga Calik Enerji Sanayi Ticaret A.S. & Calik Elektrik Dagitim A.S. dhe Limak Yatirim Enerji Uretim Isletme Hizmetleri ve Insaat A.S. me qëllim të pjesëmarrjes në procesin tenderues për privatizimin e Kompanisë;

**“Dhoma e të dhënave”** do të thotë dhoma e të dhënave në zyrat e KEK-ut, përmbajtja e së cilës është e listuar në Letrën Informuese;

**“Norma e dështimit”** nënkupton normën e interesit që duhet të jetë më e ulët se:

(a) tre për qind (3%) mbi LIBOR; ose

(b) norma maksimale e lejuar me ligj në momentin e caktuar;

**“Zbulimi i informatave”** do të thotë zbulimi i saktë dhe i drejtë (me informata të mjaftueshme për të identifikuar natyrën dhe fushëveprimin e materies së zbuluar) në Dokumentet Informative (dhe trajtat tjera të kësaj fjale duhet kuptuar njëjtë);

**“Dokumentet Informative”** janë Letra Informative dhe dy grumbujt identikë të dokumenteve të cilat përgatiten nga Shitësi apo në emër të tij, në mbështjellëset e jashtme të së cilëve gjenden nënshkrimet e Shitësit dhe Blerësit, apo përfaqësuesve të tyre, me qëllim të identifikimit;

**“Letra informative”** do të thotë letra e përshkruar si e tillë, e datës së njëjtë me këtë Marrëveshje, e cila nga Shitësi i adresohet Blerësit, dhe të cilës i bëhet referencë në paragrafin 7 të Shtojcës 5;

**“Kontest”** ka kuptimin e dhënë për këtë term në klauzolën 23;

**“Pengesë”** nënkupton çdo pretendim, të drejtë të blerjes, ngarkesë, hipotekë, siguri, peng, opion, të drejtë kapitale, autoritet për ta shitur, mbajtje të pronësisë apo të drejta të tilla të ngjashme të palëve të treta, ose çfarëdo lloji marrëveshjeje, aranzhimi apo obligimi për të krijuar të drejta të tilla;

**“ZRRE”** do të thotë Zyra e Rregullatorit të Energjisë, e themeluar në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;

**“Euro”** ose **“€”** nënkupton valutën zyrtare të Bashkimit Evropian;

**“Marrëveshja e implementimit”** do të thotë marrëveshja e implementimit mes Qeverisë së Kosovës, KEK-ut, Konsorciumit dhe KEDS-it, në formën e parapërcaktuar;

**“Marrëveshja për furnizim nga importi”** do të thotë marrëveshja për furnizim nga importi mes KEK-ut dhe KEDS-it, në formën e parapërcaktuar;

**“Ftesa për parakualifikim”** do të thotë ftesa e datës 25 janar 2011, e lëshuar nga Shitësi me qëllim të grumbullimit të ofertave për blerje të Aksioneve;

**“KEK”** do të thotë Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 70325399, me zyra të regjistruara në Rrugën Nëna Terezë, Nr. 36, në Prishtinë, Kosovë;

**“LIBOR”** nënkupton në lidhje me vlerën dhe valutën e shumës në bazë të së cilës grumbullohet interesi, normën vjetore të 1-muaji-LIBOR, e cila përcaktohet nga Shoqata e Bankierëve Britanikë rreth orës 11:00 të mëngjesit sipas kohës së Londrës, dhe e cila shfaqet në faqet ‘LIBOR01’ të Reuters-it, apo në web-faqen [www.bbalibor.com](http://www.bbalibor.com), në ditën e parë të punës së muajit në të cilin duhet bërë pagesa. Norma referente më pastaj duhet të përshtatet në fillim të secilit muaj vijues mr normën e publikuar për muajin në fjalë sipas përkufizimit të mësipërm, deri në kryerjen e pagesës së plotë;

“**Data referente**” do të thotë 6 maji 2013, apo ndonjë datë tjetër për të cilën Shitësi dhe Blerësi janë pajtuar me shkrim;

“**MZHE**” do të thotë Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Qeverisë së Kosovës;

“**Palët**” janë palët e kësaj Marrëveshjeje;

“**Komiteti i Privatizimit**” do thotë komiteti i themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe i cili ka autoritetin për të realizuar privatizimin e Ndërmarrjeve Publike (sipas përkufizimit në Ligjin Nr. 03/L-087);

“**Procedura**” nënkupton të gjitha procedurat, paditë apo veprimet (përfshirë arbitrazhin) që rezultojnë nga kjo Marrëveshje, apo në lidhje me të;

“**Çmimi i blerjes**” e ka kuptimin e dhënë në klauzolën 3.1;

“**Llogaria e caktuar e Blerësit**” nënkupton llogarinë [Banka] [Adresa] [Numri i Llogarisë] [Lloji i kodit]; Duhet shtuar detajet.

“**Garancitë e Blerësit**” janë garancitë e përcaktuara në pjesën 2 të Shtojcës 4;

“**Autoriteti rregullativ**” do të thotë gjykata apo tribunali kompetent me juridiksion në nivel kombëtar, autoriteti qeveritar apo rregullativ apo agjencia ose organi legjislativ dhe përfshin edhe bursat e njohura;

“**Kërkesat rregullative**” nënkuptojnë kushtet e zbatueshme ligjore, apo të përcaktuara nga subjektet me autoritet rregullativ që kanë fuqi ligjore;

“**Garantuesi relevant**” do të thotë:

(a) sa i përket garancive të Shitësit – Shitësi; dhe

(b) sa i përket garancive të Blerësit – Blerësi;

“**Llogaria e caktuar e Shitësit**” nënkupton:

Banka: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Adresa: 33 Garibaldi, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Numri i Xhirollogarisë: 1000400070000180

Transferi në llogarinë e Ministrisë së Financave mund të ekzekutohet përmes dy Bankave si në vijim:

a) Raiffeisen Bank International AG

BIC Code: **RZBAATWWXXX**  
Institution: **Raiffeisen Bank International AG**  
Adress: **Am Stadtpark 9, 1030**  
City: **Vienna**  
Country: **Austria**  
**Account holder details**  
Bank Sort Code: **31000**  
IBAN: **AT263100000055044937**  
Institution: **Central Bank of the Republic of Kosovo**  
Account Currency: **EUR**  
Adress: **33 Garibaldi str. 10000**  
City: **Prishtina**  
Country: **Republic of Kosovo**

b) Deutsche Bank AG

BIC Code: **DEUTDEFFXXX**  
Institution: **Deutsche Bank AG**  
Adress: **Taunusanlage 12**  
City: **Frankfurt AM Main**  
Country: **Germany**  
**Account holder details**  
Bank Sort Code: **50070010**  
IBAN: **DE31500700100935885400**  
Institution: **Central Bank of the Republic of Kosovo**  
Account Currency: **EUR**  
Adress: **33 Garibaldi str. 10000**  
City: **Prishtina**  
Country: **Republic of Kosovo**

“**Garancitë e Shitësit**” janë garancitë e përcaktuara në pjesën 1 të Shtojcës 4;

“**Marrëveshja për Shërbimet e Përbashkëta**” do të thotë Marrëveshja për Shërbimet e Përbashkëta që do të lidhet mes Kompanisë dhe KEK-ut, në formën e përcaktuar në Shtojcën 8;

“**Aksionet**” do të thotë njëzet e pesëmijë(25,000) aksionet e emituara të paguara nga [€1], secila prej të cilave përfaqëson kapital në Kompani (të çfarëdo klasi) që emitohet kohë pas kohe;

“**Deklarata e kualifikimit**” do të thotë deklarata e kualifikimit e dorëzuar nga Blerësi për Komitetin e Privatizimit, si përgjigje ndaj Ftesës për Parakualifikim;

“**Tatimim**” përfshin:

(a) të gjitha format e tatimit (përfshirë TVSH-në), dhe pagesat statutores, qeveritare, shtetërore, federale, krahinore të komunave apo të organeve lokale, doganat, taksat, kontributet, mbajtjet apo obligimet e pagueshme qoftë nën juridiksion të Kosovës qoftë në juridiksion tjetër; dhe

(b) çdo gjobë, ndëshkim, ngarkesë, interes, pagesë apo kosto të pagueshme në lidhje me çfarëdo tatimi të përmendur më sipër, përveç nëse ato mund t'i atribuohen vonesës apo dështimit të Shitësit apo Kompanisë pas Përmbylljes;

**“Këshilltari i transaksionit”** do të thotë Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), që vepron si këshilltar financiar dhe i transaksionit për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Komitetin e Privatizimit;

**“Kostot e transaksionit”** nënkuptojnë shumën prej një milion e dyqind mijë eurosh (€1,200,000), që paguhet në bazë të dokumentacionit relevant;

**“Marrëveshja e transferit”** do të thotë marrëveshja e transferit, të cilën do ta lidhin Kompania dhe KEK-u, me qëllim të transferimit të asetëve dhe personelit tek Kompania, në pajtim me dispozitat me Shtojcës 6;

**“Dollarë amerikanë”** ose **“USD”** do të thotë valuta zyrtare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës; dhe

**“Garancitë”** do të thonë Garancitë e Shitësit dhe Garancitë e Blerësit.

## PJESA 2

### Interpretimi

1.1 Në këtë Marrëveshje (përfshirë pjesën hyrëse), përveç nëse konteksti i jep kuptim tjetër, fjalët që fillojnë me shkronjë të madhe do të kenë kuptimet e dhëna në Pjesën 1 të Shtojcës 1;

1.2 Gjatë interpretimit të kësaj Marrëveshjeje:

1.2.1 referenca se një dokument i caktuar është ‘në formën e pajtuar’ do të thotë se ai është në formën për të cilën Shitësi dhe Blerësi janë pajtuar dhe të cilën ata e kanë nënshkruar me qëllim të identifikimit nga ana e Blerësit apo Shitësit;

1.2.2 kurdo që deklaratat kualifikohen me shprehjen ‘për aq sa shitësi është në dijeni’ apo nëse i bëhet referencë njohurisë, dijenisë apo besimit të Shitësit, apo kur shfrytëzohet ndonjë shprehje e ngjashme, deklaratat do të konsiderohet se është dhënë në bazë të dijenisë aktuale të Shitësit;

1.2.3 tabela e përmbajtjes, titujt dhe nëntitujt janë ofruar vetëm për të lehtësuar leximin dhe nuk kanë ndikim në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

1.2.4 përveç nëse konteksti përcakton ndryshe, fjalët që janë në njëjës do të përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas, ndërsa referenca ndaj njëjës gjini përfshin edhe gjininë tjetër. Referencat ndaj një personi do të përfshijnë personat fizikë, korporatat, shoqatat e painkorporuara, partneritetet, qeveritë, agjencitë qeveritare dhe departamentet qeveritare, organet statutore dhe subjektet tjera, pa marrë parasysh nëse kanë personalitet ligjor të veçantë apo jo, dhe do të përfshijnë trashëgimtarët e tyre.

1.2.5 fjalët **“tjera”**, **“përfshin”** dhe **“përfshirë”** nuk do të kenë konotacion kufizimi në asnjë mënyrë;

1.2.6 referenca ndaj dispozitave hyrëse, shtojcave, klauzolave dhe nënklauzolave (respektivisht) i bëhen dispozitave hyrëse, shtojcave, klauzolave dhe nënklauzolave të kësaj Marrëveshjeje (përveç nëse është specifikuar ndryshe) ndërsa referencat në ndonjë paragraf brenda Shtojcave ka të bëjë me paragrafët në të njëjtën Shtojcë (përveç nëse është specifikuar ndryshe);

1.2.7 referencat ndaj çfarëdo statuti, dispozita statutare apo legjislacionit tjetër përfshijnë referencat ndaj një statuti, dispozite statutore apo legjislacioni, përfshirë edhe ndryshimet, shtojcat, versionet e rimiratuara, konsoliduara apo zëvendësuara të tyre (qoftë para apo pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje) dhe përfshijnë të gjithë urdhrat, rregulloret, instrumentet apo legjislacionin sekondar tjetër të bërë në bazë të statutit, dispozitës statutare apo legjislacionit relevant dhe në fuqi në atë kohë;



1.2.8 referencat në çfarëdo termi ligjor në gjuhën angleze për veprim, mjet juridik, metodë të procedurës gjyqësore, dokument ligjor, status ligjor, gjykatë, organizatë, organ, zyrtar apo çfarëdo koncepti tjetër ligjor, gjendje apo gjëje nën juridiksion tjetër nga juridiksioni i Anglisë do të vlerësohet se përfshin termin më të përafërt me termin juridik anglez në juridiksionin përkatës;

1.2.9 të gjitha referencat në ‘me shkrim’ apo ‘në formë të shkruar’ përfshijnë telefaksin dhe të gjitha format tjera të lexueshme të fjalëve të cilat dërgohen në formë permanente dhe të prekshme (por jo përmes postës elektronike); dhe

1.2.10 referencat në kohën e ditës (përveç rasteve kur shprehimisht përcaktohet asisoj) i referohen kohës së Prishtinës, ndërsa referencat në një ditë kanë të bëjnë me një periudhë 24-orësh që rrjedh nga mesnata e ditës paraprake.

## **Shtojca 2**

### **Kompania**

Emri:

- Kosovo Electricity Distribution and Supply Company J.S.C. në anglisht;
- Kompania e Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh. a. në shqip; dhe
- Kosovsko Preduzeće za Distribuciju i Snabdevanje Električnom Energijom d.d., në serbisht.

Të tri versionet e emrit, në anglisht, shqip dhe serbisht do të konsiderohen emërtim i saktë dhe i vërtetë e Kompanisë.

Numri i regjistrimit:

70606119

Vendi dhe data e themelimit:

E themeluar më 24 gusht 2009 në Prishtinë, Republika e Kosovës.

Regjistruar pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, më 11 shtator 2009.

Zyra e regjistruar: Ndërtesa e Elektrokosovës, Bulevardi Bill Clinton Nr. 3, Prishtinë, Republika e Kosovës

Kapitali aksionar:

- i autorizuar:

25,000 aksione të zakonshme me vlerë prej 1 euro për copë.

- i emituar: 100% të kapitalit aksionar të Kompanisë që mbahet nga Shitësi.

Aksionarët:

- emri: Shitësi

- aksionet e mbajtura: 100% të kapitalit aksionar të Kompanisë që mbahet nga Shitësi.

Drejtorët:

Emri i Drejtorit:

Adresa:

Fadil Çitaku (kryesues)

Bregu i Diellit, Zona Qendër, H/3, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Mujë Rugova Rr. Agim Ramadani, B-II, nr. 14, 10000

Agim Nika Dardania SU7/7B, Nr21, 10000 Pristina.

Izet Ibrahim Zabeli i Ulët, 13000 Drenas

Flamur Keqa Ulpiana S/12/II, Nr. 10, 10000 Pristina.

Arben Gjukaj (ex officio) Bregu i Diellit, Rr. Ganimete Terbeshi, nr.  
18, 10000 Pristina.

Auditorë: nuk ka të emëruar

Numri Fiskal: 600678471

Numri i TVSH: 330169905

### **Shtojca 3**

#### **Obligimet për përmbyllje të procesit**

#### **1. Obligimet e Shitësit**

1.1 Pas përmbylljes, Shitësi do t'i dorëzojë dhe do të vë në dispozicion të Blerësit si në vijim:

1.1.1 dëshmitë për plotësimin e Kushteve të përcaktuara në klauzolën 4, që janë përgjegjësi e Shitësit;

1.1.2 një konfirmim nga Administrata Tatimore në formën e paracaktuar, se të gjitha taksat e pagueshme tek Administrata Tatimore nga Shitësi deri në Datën e Përmbylljes janë paguar dhe se për këtë periudhë nuk ka ndonjë formë tatimore të papaguar nga Shitësi dhe/ose Kompania, dhe, përveç kësaj, se të gjitha tatimet e pagueshme nga Shitësi për periudhën mes 1 janarit 2012 dhe Datës së Përmbylljes janë paguar;

1.1.3 bartjen e aksioneve, të nënshkruar nga bartësit e regjistruar të tyre, në favor të Blerësit, dhe ndryshimin e regjistrit të aksioneve përkitazi;

1.1.4 bartjen e aseteve që mund të barten pas Përmbylljes, së bashku me dokumentet pronësore, kurdo që kjo është e aplikueshme;

1.1.5 dorëheqjet me shkrim të të gjithë drejtorëve dhe sekretarëve të Kompanisë (në formë të pranueshme edhe për Shitësin edhe për Blerësin);

1.1.6 dorëheqjet me shkrim të auditorëve të Kompanisë, nëse ka të tillë, të cilat hynë në fuqi që nga Data e Përmbylljes (në formë të pranueshme edhe për Shitësin edhe për Blerësin); dhe

1.1.7 certifikatën e themelimit, aktet statutore të kompanisë (të azhurnuara);

1.2 Shitësi do të sigurojë bartjen e vendimeve të bordit tek Kompania:

1.2.1 mbi miratimin e regjistrimit të bartjes së aksioneve (përfshirë miratimin e certifikatave të aksioneve, në pajtim me ligjet e Kosovës);

1.2.2 mbi pranimin e dorëheqjeve të drejtorëve ekzistues dhe emërimin e personave që Blerësi i emëron si drejtorë;

1.2.3 miratimin dhe ratifikimin e nënshkrimit të të gjitha Kontratave të Ndërlidhura të Kompanisë.

#### **Obligimet e Blerësit**

1.3 Me rastin e Përmbylljes, para nxjerrjes së vendimeve nga Bordi i Kompanisë, sipas paragrafit 1.2 më sipër, Blerësi do të sigurojë, paguajë apo vë në dispozicion të Shitësit si në vijim:

1.3.1 dëshmitë mbi plotësimin e Kushteve të përcaktuara në klauzolën 4, për të cilat është përgjegjës Blerësi;

1.3.2 vërtetimin e pagesës së Çmimit të Blerjes;

## **Shtojca 4 Garancitë**

### **Pjesa 1**

#### **Garancitë e Blerësit**

##### ***Afarizmi i Kompanisë***

1. Para marrjes përsipër të biznesit të shpërndarjes dhe furnizimit nga Kompania, Kompania nuk ka (përveç kapitalit të emituar) kurrfarë asetesh, përgjegjësish apo obligimesh dhe nuk ka tregtuar fare.
2. Kompania nuk ka në pronë kurrfarë interesi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në ndonjë korporatë, partneritet, ndërmarrje të përbashkët apo subjekt tjetër afarist.

##### ***Aksionet dhe kapitali aksionar i Kompanisë/kapitalizimi***

3. Shitësi është i vetmi pronar ligjor dhe përfitues nga aksionet.
4. Aksionet përbëjnë 100% të kapitalit aksionar të emituar të Kompanisë në datën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, dhe ato janë paguar tërësisht.
5. Kompania nuk ka emituar kurrfarë fletëgarancione borxhesh dhe nuk është pajtuar se do ta bëjë këtë.
6. Nuk ekziston kurrfarë marrëveshje apo zotimi i mbetur për të ndarë, emituar apo transferuar, apo marrëveshje me ndonjë person mbi të drejtat për ndarje apo emetim të aksioneve apo fletëgarancioneve për borxhe apo letra me vlerë të Kompanisë.

##### ***Pengesat***

7. Nuk ekziston kurrfarë opsioni, e drejte për të blerë, hipoteke, ngarkese, pengu, zotimi apo forme tjetër sigurie, apo Pengese në formë tjetër të sigurisë kapitale mbi aksionet apo që i prek ato, dhe nuk ekziston kurrfarë marrëveshje apo zotimi për të dhënë apo për të krijuar të tilla, dhe kurrfarë pretendimi nuk është bërë nga asnjë person për të pasur të drejtë mbi to.
8. Nuk ekziston kurrfarë Pengese (apo marrëveshjeje apo zotimi për të dhënë apo krijuar ndonjë Pengesë) që prek ndonjë pjesë apo të gjitha asetet apo ndërmarrjen e Kompanisë dhe nuk është bërë kurrfarë pretendimi ndaj Kompanisë nga ndonjë person për të pasur të drejtë apo për të përfituar nga Pengesat në fjalë.

### ***Autoriteti; Efekti detyrues***

9. Ekzekutimi dhe jetësimi i kësaj Marrëveshjeje nga Shitësi janë bërë në mënyrë të autorizuar dhe është brenda kompetencave të shitësit dhe të gjitha pëlqimet dhe miratimet sa i përket transferit të aksioneve janë marrë dhe Shitësi garanton se të gjitha pëlqimet dhe miratimet për transferin e aksioneve janë marrë.

10. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje përbëjnë obligime detyruese për Shitësin, të cilat janë të zbatueshme në pajtim me kushtet e përcaktuara dhe nuk do të shkaktojnë shkelje të asnjë instrumenti, marrëveshjeje, ligji, urdhri, aktgjykimi apo dekreti obligues për Shitësin.

### ***Statusi i Kompanisë; dokumentet kushtetuese***

11. Kompania është shoqëri aksionare e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Kosovës dhe ka fuqi dhe autoritet korporativ për të ekzekutuar dhe kryer obligimet e veta sipas kësaj Kontrate dhe Kontratave të Ndërlidhura.

12. Përveç informatave të dhëna në Letrën Informative, nuk ka pasur kurrfarë ndryshimi të akteve themeltare dhe statutit të kompanisë dhe kurrfarë ndryshimi nuk është autorizuar ndërkohë.

13. Nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprimesh drejt bashkimit, konsolidimit, shpërbërjes, mbylljes apo likuidimit të Kompanisë.

14. Regjistri i procesverbaleve të Kompanisë përmban regjistra materialisht të vërtetë, të saktë dhe kompletuar të të gjitha takimeve dhe veprimeve të tjera të korporatës, të cilat janë zhvilluar nga Kompania, dhe se nuk ka kurrfarë vendimi të Kompanisë që do të autorizonin obligime materiale të Kompanisë të cilat nuk gjenden në regjistrat e procesverbaleve.

15. Kompania ka në çdo kohë ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e legjislacionit përkatës për ndërmarrjet tregtare, dhe të gjitha fitimet, veçantitë, vendimet dhe dokumentet tjera që është dashur të skedohen apo t'i dorëzohen referentit të kompanive apo autoritetet tjetër përkatës nga Kompania janë përgatitur në mënyrë të saktë dhe adekuate dhe janë dorëzuar apo parashtruar.

### ***Licencat; Lejet; Pëlqimet***

16. Transaksioni i paraparë me këtë Marrëveshje nuk shkel dhe nuk është jokonsistent me kushtet e licencës së Kompanisë dhe me dispozitat tjera të së drejtës së zbatueshme.

Pas Përmbylljes, Kompania do të posedojë të gjitha licencat, lejet dhe pëlqimet të cilat do t'ia lejojnë zhvillimin e afarizmit të KEK-ut që i është bartur Kompanisë para Përmbylljes.

17. Përveç Kontratave të Ndërlidhura, apo marrëveshjeve të cilat janë të parashikueshme, Kompania nuk ka hyrë në transaksionet nga lista vijuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të

tërthortë, me Shitësin apo me bashkëpunëtorët e Shitësit, në lidhje me të cilët Kompania ka obligime të cilat janë në fuqi në ditën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje:

17.1 huazimi i parave, apo garancia e ndonjë obligim; apo

17.2 blerja e çfarëdo malli, aksionesh apo letrash me vlerë; apo

17.3 kryerjen e çfarëdo pagese (përveç pagave dhe bonuseve normale).

### ***Asetet***

18. Pas Përmbylljes, të gjitha asetet që janë në pronë ligjore të Kompanisë apo të cilat i sjellin përfitime Kompanisë apo të cilat janë marrë me hua nga Kompania apo për të cilat Kompania gëzon të 'drejtën e shfrytëzimit' janë nën posedim apo kontroll të Kompanisë.

19. Kushtet dhe afatet standarde të shkruara të punësimit të Kompanisë janë të bashkëlidhura me Letrën Informativë dhe janë të zbatueshme për të gjithë punonjësit e Kompanisë.

20. Që nga data e lidhjes së kësaj marrëveshjeje, nuk janë bërë ndryshime materiale në pagat apo kushtet tjera të punësimit për zyrtarët e lartë, përveç ngritjes së pagave të bërë në pajtueshmëri me praktikat normale të Kompanisë.

### ***Punonjësit***

21. Kompania ka vepruar në pajtueshmëri materiale me të gjitha obligimet e veta sipas statutit, rregulloreve, kodit të mirësjelljes apo praktikave dhe marrëveshjeve kolektive relevante për marrëdhëniet mes Kompanisë dhe punonjësve të saj.

22. Përveç informatave të zbuluara në Letrën Informativë, nuk ekziston kurrfarë aranzhimi, zakoni apo praktike në të cilin Kompania kontribuon dhe nga i cili u paguhen kontribute punonjësve të saj në rast të pensionimit apo vdekjes apo gjatë periudhave të sëmundjeve dhe paaftësisë.

### ***Proceset***

23. Përveç rasteve të zbuluara në Letrën Informativë apo në Dhomën e të Dhënave, ose rasteve të përcaktuara në Marrëveshjen për Shërbimet e Përbashkëta, Kompania nuk ndodhet në ndonjë proces gjyqësor apo arbitrazhi, apo në procedura administrative apo penale, qoftë si paditës, i paditur apo në kapacitet tjetër në kontest i cili është i rëndësishëm në kontekst të afarizmit dhe për të cilin mund të shfaqet ndonjë veprim pas Përmbylljes.

24. Për aq sa Shitësi është në dijeni, nuk janë duke u zhvilluar dhe nuk ka rrezik të shfaqjes së kurrfarë procedure apo arbitrazhi, procedure administrative apo penale, të cilave u referohet në paragrafin 24.



## **Pjesa 2**

### **Garancitë e Blerësit**

#### ***Kriteret e parakualifikimit***

1. Informatat e shkruara që i përmban, që ndërlidhen apo janë ofruar në Deklaratën e Kualifikimit ishin dhe mbeten të sakta dhe complete në të gjitha aspektet materiale dhe nuk ka fakte të cilat nuk i janë zbuluar Shitësit, të cilët do të bënin që informatat e tilla të jenë keqduhëzuese në çfarëdo aspekti material.

#### ***Autoriteti; Efekti obligues***

2. Lidhja dhe jetësimi i kësaj Marrëveshjeje nga Blerësi është bërë në mënyrë të autorizuar dhe brenda kompetencave korporative të Blerësit.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të cilat përbëjnë obligime detyruese për Blerësin, e të cilat janë të zbatueshme sipas afateve kohore përkatëse, nuk do të shkaktojnë shkeljen e asnjë instrumenti, marrëveshjeje, ligji, urdhri, aktgjykimi apo dekreti të cilit duhet t'i përmbahet Blerësi.

#### ***Themelimi***

4. Blerësi ekziston dhe paraqet një kompani të themeluar sipas ligjeve të juridiksionit të vendit të themelimit.

#### ***Dijenja***

5. Asnjë nga drejtorët, zyrtarët, punonjësit, agjentët apo këshilltarët financiarë, të kontabilitetit apo ligjorë të Blerësit të përfshirë në blerjen e Kompanisë nuk kanë në dijeni për ndonjë fakt, çështje apo rrethanë që do të mund të pritej me arsye që të përbëjë bazë për paraqitjen e pretendimeve kundër Shitësit për shkelje të kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë dokumenti që do të ekzekutohet përmes saj, apo në bazë të kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me të.

#### ***Licencat; Lejet; Pëlqimet***

6. Blerësi i ka marrë të gjitha pëlqimet, licencat dhe lejet e domosdoshme për të lidhur këtë Marrëveshje, për të mbajtur në pronë Aksionet dhe për të kryer obligimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### ***Pagesat dhe financimi***

7. Asnjë ndërmjetës, financues apo bankier investiv nuk ka të drejtë në pagesa për ndërmjetësim, gjetje apo për pagesa apo komisione tjera në lidhje me transaksionin e paraparë me këtë Marrëveshje, në bazë të aranzhimeve të bëra nga apo në emër të Blerësit.

8. Blerësi nuk ka paguar (përveç Çmimit të Blerjes dhe nuk është pajtuar që t'i paguajë Shitësit apo punonjësve, agjentëve, nënkontraktorëve apo përfaqësuesve të tij kurrfarë shume parash, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në formë komisioni, pagese për konsulentë, pagese për agjentë apo pagese tjetër dhe nuk është pajtuar që t'i japë personave të tillë kurrfarë objekti me vlerë materiale në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes ndonjë pale të tretë, pa marrë parasysh nëse kjo është bërë nga Blerësi apo në emër të tij.

9. Blerësi ka dhe do të ketë pas Përmbylljes, të hollat e gatshme në dispozicion dhe/ose huatë e zotuarra për të paguar Çmimin e Blerjes.

## **Shtojca 5**

### **Kufizimet e përgjegjësive**

#### **1. Të përgjithshme**

1.1 Asnjë palë nuk do të ketë të drejtë të paraqesë pretendime nën garancitë për Humbjet Konsekuente, dhe rrjedhimisht garantuesi relevant nuk do të jetë përgjegjës për çfarëdo pretendimi për humbje konsekuente.

1.2 Asnjë palë nuk do të jetë përgjegjëse sa i përket pretendimeve nën garancitë, përveç nëse pretendimi në fjalë pranohet nga garantuesi relevant apo nëse vërtetohet pranë gjykatës së arbitrazhit, në pajtim me dispozitat e Klauzolës 23.

1.3 Shitësi dhe Blerësi do të sigurohen dhe do t'i ndërmarrin të gjithë hapat dhe veprimet e arsyeshme, për të realizuar kërkesat sipas garancisë. Megjithatë, kjo nuk do të parandalojë iniciimin e procedurës së arbitrazhit nga pala e dëmtuar, në pajtim me Klauzolën 23. Asgjë nën këtë Marrëveshje nuk do të konsiderohet se mund ta lirojë ndonjë palë nga detyrat ligjore, nga kapitali apo të lehtësojë humbjet apo dëmet e hasura nga ajo.

1.4 Pa paragjykuar paragrafin 3 më poshtë, asnjë palë nuk do të jetë përgjegjëse dhe kurrfarë pretendimi nuk mund të bëhet për garancitë, përveç nëse çështja që i paraprin pretendimeve të tilla mund të rregullohet, ndërsa garantuesit relevant i jepet mundësia që të rregullojë çështjen dhe çështja nuk rregullohet në mënyrë të kënaqshme për palën tjetër brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh pas datës kur pala e ka njoftuar për herë të parë garantuesin relevant mbi pretendimin në fjalë.

1.5 Secila dispozitë e kësaj Shtojce 5 duhet të lexohet dhe të kuptohet pa paragjykuar dispozitat tjera të kësaj Shtojce.

#### **2. Vlerat**

2.1 Përgjegjësia e Shitësit sa i përket cilitdo pretendim nën garanci:

2.1.1 nuk do të shfaqet përveç nëse shuma e pretendimit në fjalë e tejkalon shumën prej dyqind e pesëdhjetëmijë eurosh (€250,000), kur grumbullohet me pretendimet tjera të cilat bazohen në fakte dhe rrethana të ngjashme, e që përbëjnë një pretendim të vetëm;

2.1.2 nuk do të shfaqet përveç nëse shuma e pretendimit në fjalë, kur grumbullohet me shumën e pretendimeve të tjera të bëra kundër Shitësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje, tejkalon shumën prej një milion eurosh (€1,000,000), në të cilin rast të gjitha pretendimet e tilla (jo vetëm shtesa) do të mund të rikthehen ndërsa për pretendimet vijuese nuk do të aplikohet kurrfarë minimumi tjetër;

2.1.3 Përgjegjësia e gjithmbarshme e grumbulluar e Shitësit sa i përket garancive nuk do të tejkalojë në asnjë rast shtatëdhjetepesë për qind (75%) të Çmimit të Blerjes, përveç nëse shfaqen rrethana të cilat i nënshtrohen paragrafëve 7 dhe 9 të Shtojcës 4 të Marrëveshjes, në të cilin rast përgjegjësia e gjithmbarshme e grumbulluar e Shitësit në kuptim të Garancive nuk do ta tejkalojë kurrsesi shumë e plotë (100%) të Çmimit të Shitjes.

### **3. Afatet kohore**

3.1 Përgjegjësia e shitësit sa i përket çfarëdo pretendimi nën garanci do të pushojë në përvjetorin e tretë të Përmbylljes, përveç sa i përket çështjeve të cilat kanë qenë subjekt i ndonjë kërkesë *bona fide* me shkrim të parashtruar Shitësit nga Blerësi para skadimit të periudhës në fjalë, e në të cilën jepen detaje të arsyeshme mbi të gjitha aspektet materiale të pretendimit, përfshirë vlerësimin *bona fide* të vlerës nga Blerësi.

3.2 Të gjitha pretendimet e tilla (nëse nuk janë përmbushur, plotësuar apo tërhequr më parë) do të konsiderohet se janë tërhequr përveç nëse procedurat ligjore sa u përket atyre janë iniciuar dhe shkresat janë këmbyer brenda gjashtë (6) muajsh nga data e dërgimit të njoftimit tek Shitësi.

### **4. Rikthimi**

Asnjëra palë (dhe për qëllime të këtij paragrafi 4 Blerësi dhe Kompania do të përbëjnë bashkërisht një palë) nuk do të ketë të drejtë që të rikthejë dëmet apo të kërkojë rimbursim apo restituim (qoftë në bazë të kësaj Marrëveshjeje apo në baza tjera) më shumë se një herë për një humbje të caktuar.

### **5. Përgjegjësitë e mundshme**

Nëse paraqitet ndonjë pretendim për garanci për shkak të përgjegjësive që janë përgjegjësi të mundshme në momentin e njoftimit të tyre tek garantuesi relevant në pajtim me paragrafin 3 më lartë, garantuesi relevant nuk do të jetë i obliguar që të kryejë kurrfarë pagese për palën që parashtron pretendimin deri në momentin kur përgjegjësia e pretenduar të shndërrohet në përgjegjësi të vërtetë. Përderisa pretendimet që shfaqen në bazë të përgjegjësisë së pretenduar i njoftohen garantuesit relevant, në pajtim me paragrafin 3 më lartë, atëherë dispozitat e paragrafit 3 do të konsiderohen se do të ndryshojnë në lidhje me atë pretendim, në mënyrë që të sigurojnë se procedurat do të fillojnë brenda gjashtë (6) muajsh nga data kur përgjegjësia në fjalë pushon të jetë e pretenduar dhe të shndërrohet në përgjegjësi të vërtetë.

### **6. Aktet vullnetare**

6.1 Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse sa i përket pretendimeve të bëra në lidhje me garancitë përderisa pretendimi në fjalë t'i atribuohet.

6.1.1 ndonjë akti vullnetar, lëshimi, transaksioni apo aranzhimi të kryer me kërkesë apo pëlqim të palës tjetër apo bashkëpunëtorëve të tyre, apo, në rastin e Kompanisë, të Blerësit apo bashkëpunëtorëve të tyre, para Përmbylljes apo nën kushtet dhe afatet e përcaktuara me këtë Marrëveshje apo me ndonjërin nga Kontratat e Ndërlidhura; ose

6.1.2 çdo akti vullnetar, lëshimi, transaksioni apo aranzhimi të kryer nga pala tjetër apo bashkëpunëtorët e saj, apo në rastin e Kompanisë, nga Blerësi apo Bashkëpunëtorët e tij, nga dita e Përmbylljes e tutje.

## 7. Zbulimi i informatave

7.1 Shitësi nuk do të jetë përgjegjës për garancitë, në rast se:

7.1.1 faktet të cilat mund të rezultojnë me pretendim apo pretendim të mundshëm të garancive ishin zbuluar;

7.1.2 pretendimi i garancive shfaqet apo rritet:

(a) si rezultat i një veprimi apo lëshimi nga Shitësi, që është bërë në bazë të kërkesës apo me pëlqim me shkrim nga Blerësi pas Përmbylljes;

(b) si rezultat i një veprimi apo lëshimi nga Kompania pas Përmbylljes (që dallon nga tregtimi i zakonshëm);

(c) si rezultat i një akti apo lëshimi të kërkuar me ligj; dhe

(d) tërësisht apo pjesërisht si rezultat i kalimit apo hyrjes në fuqi të ndonjë ndryshimi legjislativ, të ligjeve, rregulloreve, kushteve apo praktikave publike të qeverisë, ndonjë departamenti apo agjencie qeveritare, apo të organeve rregullative pas Përmbylljes, pa marrë parasysh nëse të njëjtat kanë efekt retrospektiv.

Me kusht që kurrfarë përjashtimi nga përgjegjësia nuk do të aplikohet nën paragrafin 7.1.2 (c) dhe (d) në rastet kur një ligj, rregullore, kusht apo praktikë e publikuar gjegjëse diskriminon pa bazë të drejtat dhe obligimet e Blerësit dhe/ose KEDS-it në mënyrë specifike (dhe të cilitdo person dhe/ose palë të tretë tjetër) dhe duke bërë këtë ia mohon Blerësit beneficionet që i gëzon nga kjo Marrëveshje.

Për saktësinë e përkthimit nga gjuhë anglishte në gjuhë shqipe vërtetohet:

